

# AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJSI TË KUFIZUAR "FAM Hotels Group" sh.p.k

## Neni 1

### Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja,selia.

Sot më datë 14.02.2022 (dymijë e njëzët e dy), bazuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë, konkretisht në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligji nr. 9703, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ortakët themelues:

- **Enkleona Kondi**, shtetase shqiptare, e bija e Xhelo-s, lindur më 22.07.1982, në Delvinë dhe banuese në Durrës, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr.I25722079T;

dhe

- **Florjan Gjepali**, shtetas shqiptare, i biri i Demir-it lindur më 23.09.1995, në Durrës dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. J50923100B,

Kanë themeluar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "FAM Hotels Group" shpk.

## Neni 2

### Objekti

Shoqëria "FAM Hotels Group" shpk. do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj: **aktivitetet në fushën e hoteleri- turizëm.**

## Neni 3

### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "FAM Hotels Group" shpk është e pakufizuar në kohë.

## Neni 4

### Selia

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Henry Resort, Mali Robit, Rruga Pavaresia, Zona Kadastrale 1971, Objekt me nr. Pasurie 101/50, Golem, Kavaje.

## Titulli II

### Kapitali

## Neni 5

### Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë i ndarë në dy kuota në raportet:

1. Enkleona Kondi, 1 kuotë e barabartë me 51% të Kapitalit;

2. Florjan Gjepali, 1 kuotë e barabartë me 49% të Kapitalit.

## **Neni 6**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata ose nga Asambleja e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila mer një vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqsojnë.

## **Neni 7**

### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

**7.1** Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**7.2** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

## **Neni 8**

### **Kalimi i kuotave me kontratë**

**8.1** Në rastin e shitjes së kuotave, ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes të pjesës së kuotave ose të kuotës që ortaku dëshiron të shesë, Ortaku që dëshiron të shesë pjesën e tij komunikon me shkrim me ortakun tjetër. Çmimi i shitjes do të përcaktohet me marrëveshje të palëve ose në rast të kundërt nga një shoqëri audituese.

**8.2** Pjesët të kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin paraprak të Asamblese së Shoqërisë dhe pasi të jetë ezauruar e drejta e parablerjes.

**8.3** Proçedura e njoftimit dhe marrjes së miratimit është si më poshtë:

-Ortaku që dëshiron të shesë pjesën e tij njofton me shkrim administratorin e shoqërisë i cili njofton brenda dy javësh Asamblenë e Ortakëve. Në këtë njoftim propozohet edhe data e mbledhjes së Asamblesë, jo më vonë se 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimit me qëllim miratimin e transferimit.

-Gjatë kësaj kohe administrator përgatit materialet e mbledhjes dhe raportet e ekspertëve të fushësë me propozimet përkatëse në lidhje me transferimin.

-Asambleja miraton ose refuzon transferimin me shumicë të thjeshtë në mbledhjen e caktuar si më sipër.

Në rast se shoqëria ka vetëm dy ortakë dhe ortaku që kërkon të largohet është edhe administrator, ky i fundit njofton me shkrim ortakun tjetër.

8.4 Ortaku apo administrator që kërkon të largohet nga shoqëria detyrohet të mos ushtrojë aktivitet konkurrues në kuptimin e nenit 17 të ligjit 9901, për një periudhë një vjeçare nga data e largimit. Ky kufizim mund të lehtësohet apo hiqet me marrëveshje të palëve.

### **Titulli III**

### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 9**

##### **Të drejtat dhe detyrimet**

Përveç çështjeve të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja ka të drejtë:

- të miratojë organigramën, numrin e punonjësve dhe përzgjedhjen e tyre, duke marrë parasysh përzgjedhjen paraprake që kanë bërë ortakët
- të zgjidhë dhe miratojë marrëveshjet në konflikt interesi,
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose statute.

#### **Neni 10**

##### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

**10.1** Administratori mund të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojë të arsyeshme vetë dhe sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me nenin 84 të Ligjit dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit sipas Nenit 82 të ligjit.

**10.2** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi në postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

**10.3** Mosnjoftimi për mbledhjen i personave që kanë të drejtën për të marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

#### **Neni 11**

##### **Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

**11.1** Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk fillojnë nëse nuk plotësohet kuorumi i parashikuar nga neni 86 i Ligjit.

**11.2** Në rast se nuk arrihet kuorumi i kërkuar sipas paragrafit të mësipërm në mbledhjen e parë, mbledhja e Asamblesë së ortakëve shtyhet për një ditë tjetër, por jo më shumë se 30 ditë të njëpasnjëshme.

**11.3** Ortakët ose përfaqësuesit me prokurë mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

11.4 Të pranishmit në mbledhje caktojnë si kryetar anëtarin më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Procesverbalit i mbledhjes duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

11.5 Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohej të marrë pjesë dhe në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

11.6 Ushtrimi i votës dhe kufuzimet përkatëse për ortakun administrator rregullohen sipas ligjit.

11.7 Me pëlqimin e pjesëmarrësve në mbledhje, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar nëse ja kërkon Asambleja), ti shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të atyre të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditë të plota në të cilën përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të rendit të ditës që do të diskutohet.

11.8 Projekt vendimet që do të miratohen në asamble janë përgatitur paraprakisht nga administratori dhe i janë dërguar ortakëve për tu njohur me to.

11.9 Vendimet e Asamblesë merren me vendim të hapur. Ortakët shprehin dakortësinë e tyre me zë, gjë që regjistrohet në procesverbal dhe me anë të nënshkrimit të vendimeve të procesverbalit. Në fund të mbledhjes ortakët mund të marrin një kopje të procesverbalit dhe vendimeve.

11.10 Shoqëria mund të aplikojë realizimin e asambleve me vendime qarkulluese. Mbledhje të tilla nuk kërkojnë komunikime të formave të tjera. Në këtë rast mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse të gjithë ortakët votojnë pro vendimit.

## Neni 12

### Votat e ortakëve

12.1 Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokurë përfaqsimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokurë përfaqsimi, ka të drejtën e një vote.

12.2 Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose me prokurë, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

12.3 Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen me dije në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

## Titulli IV

### Administratoret

## Neni 13

### Emërimi i Administratorëve

Administratori i shoqërisë emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për një afat jo më shumë se 5 vjet me të drejtë rizgjedheje me një shumicë të thjeshtë.

Administrator i parë zgjidhet z. Florjan Gjepali.

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorit

Administratori i Shoqërisë është përgjegjës sipas ligjit për administrimin e brëndshëm dhe transaksionet e shoqërisë me palë të treta, duke marrë parasysh kufizimet e këtij statuti.

### **Neni 15** **Kufizimet e kompetencave**

15.1 Administratori do të ushtrojë lirisht dhe pa kufizime kompetencat e mësipërme që përfshijnë vlera financiare deri në 500.000 (pesëqindmijë) lekë në muaj.

15.2 Për veprimet e tjera financiare dhe tregtare me vlerë mbi 500.000 (pesëqindmijë) lekë në muaj do të nevojitet nënshkrimi i përbashkët i administratorit dhe financierit të shoqërisë ose i administratorit dhe ortakëve të shoqërisë.

### **Neni 16** **Shkarkimi dhe largimi i administratorit**

Administratori shkarkohet nga asambleja me shumicë të thjeshtë nëse:

1. Verifikohet një nga rastet e parashikuara nga dispozitat e Ligjit, përfshirë nenin 95 paragrafi 6;
2. vuan ose mund të vuajë nga çrregullimet mendore
3. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë
4. humbet besimin e ortakëve për aftësitë e drejtimit të shoqërisë nga ana e tij
5. për shkaqe të tjera ligjore.

### **Neni 17** **Shpërblimi i administratorit.**

Administratori do të paguhet me një pagë fikse mujore që do të përcaktohet nga Asambleja e Shoqërisë.

### **Titulli V** **Dividentët**

### **Neni 18** **Dividentët**

18.1 Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të ligjit, shoqëria me anë të një vendimi të kualifikuar mund të shpërndajë divident.

18.2 Dividentët do të ndahen në raport të barabartë ndërmjet dy ortakëve pavarësisht kuotës që secili ortak përfaqson në kapitalin ligjor të shoqërisë.

### **Titulli VI** **Prishja dhe njoftimet**

### **Neni 19** **Prishja dhe likuidimi**

Shoqëria priset për një nga rastet e parashikuara në ligj.

Në rast likuidimi të shoqërisë, likujduesi me autoritetin që i jepet me shumicë të cilësuar nga Asambleja e përgjithshme dhe në përputhje me ligjin mund të shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës të pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund të vlersojë pasuritë dhe të përcaktojë sesi do të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

#### **Neni 20**

##### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

#### **Neni 21**

##### **Njoftimet**

Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim me letër rekomandë me marrje përgjigje, ose me post elektronike në adresat e mëposhtme:

Për ortakun Enkleona Kondi: [ekleona.kondi@gmail.com](mailto:ekleona.kondi@gmail.com)

Për ortakun Florjan Gjepali: [Florjangjepali3@gmail.com](mailto:Florjangjepali3@gmail.com)

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË “FAM Hotels Group” SHPK**

**ENKLEONA KONDI**

*Enkleona kondi*



**FLORJAN GJEPALI**

*Florjan Gjepali*

